



Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën

Parimi: Personat që janë dënuar për krime në lidhje me konfliktin nuk duhet të mbajnë pozita publike ose të trajtohen si heronj kombëtarë

Studim i rasteve



Parimet për ballafaqimin me të kaluarën

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo formal i përbërë nga 5 organizata dhe një eksperte: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës, Integra, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, BIRN dhe Nora Ahmetaj. Grupi ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët për të hartuar dhe aprovuar një grup parimesh të cilat do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si do të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit/at, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike. Iniciativa ka për qëllim që të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si dokument referues, ku secili/a që shkel parimet e tij/saj duhet të mbahet moralisht përgjegjës. Andaj, qëllimi është që të aplikohen këto parime dhe të respektohen vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë, në mënyrë që të sigurohet që viktimat dhe të mbijetuarit të mos dëmtohen dhe se veprimet që ndërliken me ballafaqimin e të kaluarës do të kontribuojnë në procesin e pajtimit¹. Tani kur parimet janë zhvilluar e janë organizuar, gjithashtu edhe janë të shpjeguara mirë, ka një rëndësi kryesore që të prezantohen tek një publik i gjerë dhe të promovohen në mënyrë korrekte. Ne besojmë se një nga mënyrat për të bërë njerëzit të kuptojnë për rëndësinë e parimeve është të tregohet për dëmet, pasojat dhe dhimbjen, të cilat mund të shkaktohen në situatat kur parimet janë të shkelura. Prandaj koalicioni do të publikojë disa analiza të cilat do të përpilohen nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe ne do të përpiqemi që të sjellim shembuj konkret nga e kaluara ku parimet janë përdorur në mënyrë të duhur apo edhe janë keqpërdorur. Një nga këto parime është “Personat që janë dënuar për krime në lidhje me konfliktin nuk duhet të mbajnë pozita publike ose të trajtohen si heronj kombëtarë”.

Personat që janë dënuar për krime në lidhje me konfliktin nuk duhet të mbajnë pozita publike ose të trajtohen si heronj kombëtarë

E drejta për garantimin e mos-përsëritjes, si shtylla e katërt e Ballafaqimit me të Kaluarën, thotë se ata/o që janë të dënuar për krime lufte në lidhje me konfliktin e armatosur nuk duhet të mbajnë asnjë detyrë institucionale, as nuk duhet të kenë qasje në informacione të ndjeshme në lidhje me sigurinë shtetërore dhe publike. Trajtimi i të dënuarve për krime lufte si heronj cenon dinjitetin e viktimave dhe të mbijetuarve/ave. Për më tepër, lavdërimi dhe mbajtja e të dënuarve për krime lufte në një pozicion publik do të dëmton seriozisht procesin e rivendosjes së besimit të qytetarëve ndaj institucioneve, veçanërisht për komunitetin e viktimave. Në një afat më të gjatë, lavdërimi i të dënuarve për krime lufte do të shtrembëronte narrativat historike për brezat e ardhshëm.

Hyrje

Personat të cilët kanë kryer krime të luftës, krime të cilat janë vërtetuar me vendime të gjykatës, janë persona të cilët duhet të vuajnë dënimin e tyre të dhënë nga gjykata dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të glorifikohen. Gjithashtu, ata nuk duhet të mbajnë pozita të larta publike dhe shtetërore, edhe pas vuajtjes së dënimit të tyre. Glorifikimi dhe trajtimi i tyre si heronjë është i papranueshëm dhe nuk e ndihmon procesin e ballafaqimit me të kaluarën. Një gjë e tillë e dëmton përpjekjen e viktimave për të tejkaluar dhimbjet dhe traumat e tyre, të cilat ata i kanë përjetuar gjatë luftës së fundit në Kosovë, si dhe përpjekjen mbi 20 vjeçare për të vënë në pah para qytetarëve narrativat e sakta të ngjarjeve të luftës. Viktimat apo të mbijetuarit e luftës së fundit në Kosovë mund të ndihen të pasigurtë, sepse glorifikimi i atyre që kanë kryer krime i vendosë ata në pozitë më të lartë në relacion me viktimat. Në këtë mënyrë dinjiteti i viktimave rrënohet përsëri dhe besimi i tyre ndaj institucioneve të shtetit humbet.

Raste të tilla kur persona të caktuar të cilët janë dënuar për krime të luftës, kanë mbajtur pozita të larta shtetërore ose edhe janë nderuar me dekorata të ndryshme, e janë trajtuar si heronj, kanë ndodhur në të kaluarën por vazhdojnë të ndodhin edhe sot. Kjo padyshim që është një paradoks i llojit të vet, duke qenë se njëri pushtet shtetërorë i dënon për veprimet e

¹ Principi ALB (vibr-ks.org)



kryera gjatë një periudhe të caktuar, ndërsa pushteti tjetër i përgëzon për ato veprime. Gjëra të tilla mund të shkaktojnë konfuzion tek qytetarët, duke vënë në pikëpyetje së pari kredibilitetin e sistemit të drejtësisë dhe në anën tjetër padyshim edhe kredibilitetin e institucioneve të tjera publike dhe politike.

Shumë raste të tilla kishin ndodhur në Serbi, e ndër to ishte edhe ai i V.L., i cili ishte komandant i Korpusit të Prishtinës të Ushtrisë Jugosllave, e i dënuar nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për krime lufte gjatë konfliktit në Kosovë. Pas lirimit të tij nga vuajtja e dënimit, ai ishte mirëpritur dhe ishte lartësuar si hero². Pak kohë më vonë ai ishte emëruar si pedagog në Akademinë Ushtarake Serbe³. Për një gjë të tillë, përpos që kishte pasur reagime nga komuniteti ndërkombëtarë, gjithashtu kishte reaguar edhe në atë kohë presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi⁴. Reagimi i ish presidentit mund të përmendet si një shembull pozitiv për të ndjekur edhe në Kosovë, për këdo që ka qenë i dënuar me aktgjykime të plotfuqishme për krime lufte, duke pamundësuar emërimin e tyre në pozita të larta dhe të rëndësishme shtetërore.

Edhe pse de jure me asnjë ligj të Kosovës nuk ndalohet ushtrimi i veprimtarive të ndryshme publike në rastin se ata janë të dënuar, megjithatë kjo nuk paraqet një shembull të mirë për t'u ndjekur. Gjithsesi gjykata në aktgjykimin të cilin ajo e nxjerrë, ka të drejtë që përpos dënimit kryesorë apo alternativ, të shqiptojë edhe dënime plotësuese, të cilat konsistojnë në ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, apo edhe ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Këto dënime janë të parapara me Kodin Penal të Republikës Kosovës⁵, si dhe ekzekutimi i tyre bëhet përmes Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁶. Për fat të keq këto dënime plotësuese nuk praktikohen nga gjykatat vendore në rastet për krime lufte.

Për shkak të peshës së madhe të cilën e ka një çështje e tillë, ne kemi analizuar disa raste të cilat kanë shkëlur këtë parim. Përmes këtyre analizave do të kuptojmë që një dukuri e tillë ndodh në vazhdimësi. Prandaj është e rëndësishme që të identifikohen dhe raportohen rastet e tilla në mënyrë që aktet e tilla të mos kthehen në precedent negativ.

Glorifikimi dhe emërimi i të dënuarve për krime lufte në pozita të larta politike

Në bazë të të dhënave të cilat janë siguruar nga FDHK në lidhje me rastin e S.S., ish komandantit të shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, ai ishte i akuzuar në rastin “Drenica 2” dhe gjithashtu i dënuar për krime të luftës kundër popullsisë civile. I njëjti ishte dënuar me aktgjykim të formës së prerë, me të cilin i ishte shqiptuar dënimi unik me burgosje në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vitesh⁷.

Përkundër këtij fakti, në momentin kur ai ishte liruar nga vuajtja e dënimit, kishte filluar të trajtohej si hero i luftës. Mbi të gjitha ai kishte pranuar edhe pozita të larta publike/politike, e që një gjë e tillë padyshim ndikon negativisht në trajtimin dinjitoz të viktimave.

Gjatë kohës sa ai ishte në vuajtje të dënimit të tij, S.S. kishte pranuar një dekoratë nga ana e Presidentit të atëhershëm të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës⁸. Një gjë e tillë paraqet një precedent të dëmshëm, pasi në rast se një person lavdërohet dhe dekorohet për arritjet e tij gjatë një periudhe të caktuar, që në këtë rast paraqitet konflikti i armatosur dhe i njëjti është në vuajtje të dënimit për krimet të cilat i ka kryer gjatë këtij konflikti, është kundërthënëse dhe e dëmshme.

Ai u lirua me kusht nga burgu me rastin e mbajtjes së dy të tretave të dënimit të shqiptuar, më 25 janar të vitit 2019⁹. Menjëherë pas lirimit të tij, një numër i konsiderueshëm i personaliteteve publike kishin shkruar për të në rrjete të ndryshme sociale, duke e mirëpritur dhe duke e trajtuar atë si një hero.

Presidenti i aso kohe i Republikës së Kosovës, në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook kishte postuar një fotografi me S.S., ku kishte shkruar “me heroin e gjallë, gjeneralin S.S. në liri, Kosova është më e mirë dhe më e sigurt¹⁰”. Në të njëjtën

² Balkan Insight, 03.12.2015, <https://balkaninsight.com/2015/12/03/krimineli-i-liruar-i-ushtrise-C3%AB-jugosllave-rikthehet-n%C3%AB-serbi-12-03-2015/?lang=sq>

³ Balkan Insight, 18.10.2017, <https://balkaninsight.com/2017/10/18/ish-komandanti-serb-i-d%C3%ABnuar-p%C3%ABr-krime-lufte-pedagog-n%C3%AB-akademin%C3%AB-ushtarake-10-18-2017/?lang=sq>

⁴ Kallxo.com, 26.10.2017, <https://kallxo.com/shkurt/thaci-kerkon-reagim-te-se-per-gjeneralin-serb-te-punesuar-ne-akademi-ushtarake/>

⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli – Dënimet Plotësuese, Neni 62-63, faqe 17-18, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

⁶ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Pjesa e Katërt – Ekzekutimi i Dënimeve Plotësuese, Kreu XI-XII, Neni 160-163, Faqe 41-42, (Microsoft Word - 1 - Ligji nr nr 04L-149 p\353r ekzekutimin e sanksioneve penale - shqip_red .doc) (rks-gov.net)

⁷ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Raporti vjetor i FDH Kosovë i vitit 2017, “Gjykimet për Krime Lufte – Çka më tutje?”, Faqe 154, <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/2017.pdf>

⁸ Kallxo.com, 16.02.2018, <https://kallxo.com/shkurt/njerez-te-denuar-e-te-akuzuar-nder-te-dekoruarit-e-presidentit-thaci/>

⁹ Balkan Insight, Janar 2019, Ish-komandanti i Kosovës Sylejman Selimi lirohet nga burgu | Balkan Insight

¹⁰ Facebook, Hashim Thaçi, <https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial/photos/a.606015099468853/2428212453915766/?type=3&theater>



mënyrë edhe Isa Mustafa, i cili ishte kreu i opozitës së atëhershme, kishte shkruar në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook “më gëzoi lajmi për lirimin e gjeneral S.S.. Gjeneral S.S. dha një kontribut të veçantë në luftë dhe në paqe. Gjeneral, të uroj shëndet!”¹¹ Edhe kryeministri i atëhershëm Ramush Haradinaj kishte postuar në të njëjtën mënyrë për t’u uruar S.S. për lirimin e tij. Në llogarinë e tij në Facebook shkroi “Heroi i luftës iu rikthye lirisë. Mirë së vjen, Gjeneral S.S.!”¹²

Është jo etike dhe e papranueshme që udhëheqësit më të lartë politik të vendit të glorifikojnë një personalitet i cili është dënuar për krime lufte.

Përpos urimeve dhe lavdërimeve publike të bëra nga personalitetet kyçe të asaj kohe në Kosovë, për shkak të lirimit të tij nga burgju, vet kryeministri i Kosovës i asaj kohe, disa ditë më pas, e emëroi S.S. si këshilltarë të tij politik¹³.

Në raportin e vitit 2018 të FDHK, thuhet se kjo është hera e parë që një i dënuar për krime lufte të emërohet në funksion të lartë politik. Mbi të gjitha sipas këtij raporti thuhet se nuk ka dispozita ligjore që e ndalojnë një gjë të tillë, por që pesha politike dhe juridike e një vendimi të tillë është shumë e madhe, si për ndjekjen e kryerësve të tjerë të krimeve të luftës ashtu edhe për sundimin e ligjit mbi politikë¹⁴.

Një veprim i tillë ishte kundërshtuar nga dy organizata jo-qeveritare dhe gjithashtu nga Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Philip Kosnett¹⁵. Sipas reagimit të publikuar nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR Kosovë) dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR Serbia), ata kanë dënuar dhe kanë kundërshtuar emërimin e S.S. si këshilltar të kryeministrit Ramush Haradinaj. Sipas tyre “Kriminelët e luftës nuk kanë vend në Qeveri”¹⁶.

Pas këtyre ngjarjeve të cilat ndodhën pas lirimit të tij nga burgju, S.S. ishte propozuar për riemërim në pozitën e ambasadorit të Kosovës në Republikën e Shqipërisë, pozitë të cilën e kishte mbajtur edhe para arrestimit të tij në vitin 2013. Për këtë rast ishte deklaruar avokati i tij mbrojtës, duke thënë se “asnjë dispozitë ligjore në Republikën e Kosovës nuk e ndalon emërimin e S.S. në cilësinë e ambasadorit të Republikës së Kosovës në Shqipëri ku ai është edhe këshilltar në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe kjo është tejet një çështje normale që ai të riemërohet në Republikën e Shqipërisë për shkak se këtë pozitë e ka mbajtur edhe më herët”¹⁷.

Sikurse edhe për emërimin në pozitën e këshilltarit të kryeministrit të Republikës së Kosovës, ashtu edhe pas riemërimit në pozitën e Ambasadorit të Kosovës në Republikën e Shqipërisë, sërish reagoi Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett. Ai në llogarinë e tij në rrjetin social Twitter kishte pyetur se “çfarë mesazhi i dërgon Kosova botës, kur e propozon një kriminel lufte të dënuar që ta përfaqësojë atë si Ambasador? A tregon kjo respektim të sundimit të ligjit”¹⁸?

Por përkundër faktit të reagimeve ndaj një veprimi të tillë, të cilat publikisht thoshin se një gjë e tillë nuk është e drejtë, megjithatë kjo nuk u mor në konsideratë që këto veprime të merrnin fund.

Emërimi i dënuarve për krime lufte në pozita të larta publike

Edhe sot kur ne po flasim për parimet për ballafaqimin me të kaluarën, pozita e B.Z., person me bagazh publik dhe politik është në kundërshtim të plotë me parimin që po e shtjellojmë në këtë analizë. Atij i ishte konfirmuar një pjesë e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe një pjesë e ankesës së paraqitur në dobi të tij në lidhje me dënimin, dhe si përfundim i ishte shqiptuar dënimi me gjashtë vite burgim nga Gjykata Supreme e Kosovës më 10 prill 2009, si aktgjykim i formës së prerë për *krime lufte kundër popullsisë civile*¹⁹. Përkundër faktit se i njëjti është dënuar për krime lufte, ai aktualisht ushtron një funksion shumë të rëndësishëm shtetëror, në cilësinë e kryeshefit ekzekutiv në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës²⁰. Është e qartë që ai udhëheq një nga institucionet shumë të rëndësishme të vendit dhe ku ka qasje në dokumente të ndjeshme nga lëndët arkivore shtetërore.

¹¹ Facebook, Isa Mustafa, <https://www.facebook.com/IsaMustafaKS/posts/2027743190625241>

¹² Facebook, Ramush Haradinaj, <https://www.facebook.com/RamushHaradinajOfficial/photos/a.179881242136298/1045931905531223/?type=3&theater>

¹³ Insajderi, 19 qershor 2019, <https://insajderi.org/emerimet-e-te-denuarve-per-krime-lufte-e-korrupsion-ge-nxiten-reagimin-e-nderkombetareve/>

¹⁴ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Krimet e luftës – Tranzicioni që nuk premtion, Raporti vjetor I FDHK për vitin 2018, Faqe 111, [Krimet e luftës Tranzicioni që nuk premtion.pdf \(hlc-kosovo.org\)](#)

¹⁵ Twitter, Ambassador Philip S. Kosnett, 06.02.2019, <https://twitter.com/USAmbKosovo/status/1093221846043029505>

¹⁶ YIHR Kosova and YIHR Serbia, <https://yih-ks.org/yihr-kosova-dhe-yihr-serbia-denojne-dhe-kundershtojne-emerimin-e-sylejman-selimit-si-keshilltar-te-kryeministrit-ramush-haradinaj-kriminel-et-luftes-nuk-kane-vend-ne-qeveri/>

¹⁷ Insajderi, 23.04.2019, [Sylejman Selimi ambasador i Kosovës në Shqipëri ? – Flet avokati i tij - Insajderi](#)

¹⁸ Twitter, Philip S. Kosnett, <https://twitter.com/usambkosovo/status/1124308101388173312>

¹⁹ Aktgjyrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, 10 prill 2009, https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Selim-Krasniqi-dhe-te-tjere-Aktgjykimi-10.04.2009_Redacted-1.pdf

²⁰ Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, <http://www.asha-ks.net/?page=1,45>



Në po të njëjtin vit kur B.Z. u dënua, përkatësisht nga 23 nëntori i vitit 2009, pas vuajtjes së dënimit, ai kishte mbajtur pozitën e këshilltarit për media dhe marrëdhënie me publikun në Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës (PTK)²¹. Ndërsa nga 25 gushti i vitit 2014, ai ishte caktuar si ushtrues detyre i drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”²² dhe ishte emëruar si drejtor i po të njëjtës më 3 tetor të vitit 2014²³.

Më 17 dhjetor të vitit 2019, B.Z. mori pozitën të cilën tashmë e ushtron, në cilësi të kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me mandat 3 vjeçar²⁴.

Emërimi i personave të dënuar për krime lufte si udhëheqës të institucioneve kulturore, edukative e sidomos atyre që përmbajnë dokumentacione të ndjeshme është i papranueshëm dhe mund të dëmtojë imazhin e këtyre institucioneve por edhe të shtetit të së drejtës.

Rekomandime

Në mënyrë që të ketë sa më pak raste të tilla në të ardhmen, në rend të parë rekomandojmë që “Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën”²⁵, të respektohen dhe adaptohen nga të gjithë akterët politik dhe publik, e të cilët merren me trajtimin e së kaluarës.

Vërtetimi i të kaluarës kriminale duhet rregulluar me akte të ndryshme ligjore, duke u paraqitur si kriter bazë, për të gjithë personat të cilët aplikojnë në pozita të larta e në institucione publike dhe shtetërore dhe jo vetëm ndaj personave të cilët aplikojnë për t’u bërë pjesë e sistemit të drejtësisë.

Në kuadër të strategjisë nacionale për Drejtësi Tranzicionale e cila është në proces të hartimit, duhet të përfshihen dispozita me të cilat personave të cilët janë të dënuar me aktgjykime të plotëfuqishme për krime lufte, të mos u lejohet të bartin pozita të larta vendimmarrëse ose edhe publike/politike.

Ky projekt implementohet me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë përmes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe përmbajtja e përfshirë në këtë analizë nuk pasqyron pikëpamjet e tyre.

²¹ Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, <https://biblioteka-ks.org/Ngjarje/N-X-1.php>

²² Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, <https://www.biblioteka-ks.org/Ngjarje/N-ud.php>

²³ Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, <https://www.biblioteka-ks.org/Ngjarje/N-X-1.php>

²⁴ Insajderi, 17 dhjetor 2019, <https://insajderi.org/kater-dite-pasi-u-ftua-nga-specialja-babai-i-keshilltarit-te-pacollit-emerohet-kryeshef-ne-agjenci-shteterore/>

²⁵ [Principi ALB \(yihr-ks.org\)](https://www.principi.alb/)

 [@dwpkosovo](#)

 [@dwpkosovo](#)

 [@dwpkosovo](#)

 [dwpkosovo](#)